



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:289294

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05430084

C.nr.1969/23

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Genc Hasani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. T. të cilën e përfaqëson Av. Besart Kadriu nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, Baza juridike: Pagesa mbi bazën e licencimit, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse në procedurën e Ndërmjetësimit, jashtë seancës me dt.08.03.2024 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE, me numër të lëndës Nd.nr..., e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Mitrovicë me datë ..., në mes të paditëses Mimoza Tahiri të cilën e përfaqëson Av. Besart Kadriu nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, Baza juridike: Pagesa mbi bazën e licencimit, dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv-përmbaues.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore Mitrovicë, me datë ..., kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike: Pagesa mbi bazën e licencimit.

Qendra për Ndërmjetësimin, e ka njoftuar gjykatën me dt..., se palët ndërgjyqëse, kanë arritur marrëveshje për këtë çështje kontestimore, duke ia dorëzuar gjykatës marrëveshjen e lidhur në mes tyre.

Gjykata duke ju referuar të cekurave më lartë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 3.3, 411 dhe 412 të LPK, e lidhur me nenin 3, 4, 10 dhe 14 Ligjit për Ndërmjetësim me nr.06/L-009, i cili ka hyrë në fuqi me dt.28.07.2018, ka ardhur në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të aprohet, pasi plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe e njëjta është dokument përmbaues, pra paraqet titullin përmbaues.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr. 1969/23 me dt.08.03.2024

Gj y q t a r i
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.